



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-077

Prishtinë, më 1 tetor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 1 TETOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Sasha Milosavleviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24 shtator 2012,
2. Konfirmimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 24 shtator 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 24 shtator 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare më 4 tetor 2012:

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendit, për mbledhjen plenare më 4 tetor 2012, t'ia propozojë këtë:

Rend të ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Votimi i Raportit vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pagat e funksionarëve publikë,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për komunikimet elektronike,
10. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011,

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave,
12. Shqyrtimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe
13. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Alma Lama, lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës.

Gjithashtu, Kryesia e shqyrtoi kërkesën e ministrit të Punëve të Jashtme z. Enver Hoxhaj, për shtyrjen e datës së mbajtjes së interpelancës sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës.

Kryesia e shtyu për mbledhjen e radhës caktimin e datës për mbajtjen e interpelancës me ministrin Enver Hoxhaj.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara

Projektligjin e lartshënuar Kryesia e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare të radhës, pas 4 tetorit 2012.

2. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohet Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision Funkcional, që ta shqyrtojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i hartuar nga grupi i deputetëve nënshkrues dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin preliminar para shqyrtimit të parë.

2. Komisioni ta ketë parasysh mendimin e Qeverisë së Kosovës për mundësinë e rihartimit të një projektligji të ri, meqë rezulton se përmbajtja e ligjit aktual ndryshohet mbi 50%.

3. Procedimi i Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohen Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media që ta shqyrtojnë Projektligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë dhe Kuvendit t'ia paraqesin Raportin preliminar para shqyrtimit të parë.

2. Komisioni t'i ketë parasysh vërejtjet e Qeverisë së Kosovës që nëse ky projektligj nuk harmonizohet-plotësohet me Kodin Penal të Kosovës vështirë se mund të zbatohet dhe si pasojë do të krijojë konflikt të hapur ligjor.

4. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të japë mendim lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i hartuar nga Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

2. Njëherësh kërkohet që të bëhet verifikimi i ndikimit buxhetor, si dhe deklarata për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji.

3. Qeveria duhet ta paraqesë mendimin e vet dhe deklaratën për verifikimin e ndikimit buxhetor me shkrim në afat prej një muaji nga dita e pranimi të projektligjit.

5. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011

Raportin e Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kryesia e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare të radhës, pas 4 tetorit 2012.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale